



Republika e Kosovës - Komuna e Vushtrrisë

Republika Kosova- Opstina Vucitrn

Republic of Kosovo- Municipality Vushtrri

Drejtoria Komunale e Arsimit

PROCESVERBAL

Konsultimi publik për Draft-Planin Komunal të veprimit për Ekipin për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026.

Datë: 04.03.2024

Ora: 11:00

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin: prindër, drejtorët e shkollave të komunës së Vushtrrisë, psikologët e shkollave, përfaqësueset e Njësitit për të drejtat e fëmijëve znj. Hyrie Uka dhe zyrtarja e lartë për koordinimin e të Drejtave të Njeriut dhe zyrtare për Barazi Gjinore znj. Remzije Zekolli, takimin e shpalli të hapur z. Enver Bajrami i cili edhe e prezantoi draft planin, i cili plan bazohet në pesë shtylla:

1. Braktisja
2. Braktisja e heshtur
3. Parandalimi
4. Mosregjistrimi
5. Rikthimi në procesin mësimor

Tek analiza e gjendjes pati diskutime rreth braktisjes dhe braktisjes së heshtur.

Remzije Zekolli, zyrtare e lartë për koordinimin e të Drejtave të Njeriut dhe zyrtare për Barazi Gjinore tha: të shkurtesat faqe 3, mendoj se duhet të jetë NJKDNJ- Njësi Komunal për të Drejta të Njeriut;

Te hyrja, faqe 4, të plotësohet: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës; Rregullorja për Realizimin e të Drejtave Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda;

Te konteksti, faqe 6 duhet të jetë komuna ka themeluar, e jo formuar, sepse NJDKNJ, komuna nuk harton institucione, por themelon, ndërsa komuna harton Rregullore, Plane etj.

Hyrie Uka, zyrtare për të Drejtat e Fëmijëve: tha se në këtë plan të veprimit duhet të përfshihet edhe ligji për mbrojtjen e fëmijëve dhe të ceket roli i njësitit komunal dhe detyrat e tij në këtë Draft - Plan.

Nasuf Tahiri, drejtor nga SHFMU “28 Nëntori” Vërrnicë: flet për vështirësitë që po has ekipi për braktisje dhe parandalim në nivel shkolla kur bëhet fjalë për nxënës në rrezik të braktisjes dhe nxënës të evidentuar me mungesa të shumta.

Halil Parduzi, drejtor në SHMU 2 Vushtrri: tregon për praktikën që ekipi në nivel shkolle ka ndërmarrë për rikthimin e nxënësve në procesin mësimor.

Ardian Jashari, drejtor në SHFMU “Liria” Stroc; tha se është e nevojshme të mbahen trajnime për Ekipin kundër braktisjes në nivel shkolle sepse është esenciale të dihet qartë se si t’u qasen nxënësve në rrezik të braktisjes.

Po ashtu drejtori Ardian tha se Draft-Plani komunal i Veprimit duhet të jetë në harmoni të plotë me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve.

Faruk Selimi, drejtor i SHFMU “Martirët” Reznik: tha se e përshëndet punën që ka bërë Ekipi komunal për EPRMB dhe po ashtu punën e MASHT-it sepse çdo herë ka nevojë për risi dhe të ketë mundësi për futjen e të dhënave shtesë për nxënësit të cilët janë nxënës potencial të braktisur shkollën.

Procesverbalit i bashkëngjitet edhe listën e pjesëmarrësve.

Procesmbajtëse ,

Edona Shotani
